




Nr. **3389** i Prot.
Tiranë, 31.10.2018



Nr. i Prot.
Tiranë, 31.10.2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KUVENDIT TË SHQIPËRISË DHE UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”, VLORË

Kuvendi i Shqipërisë dhe Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë, me qëllim rritjen e kontributit të universiteteve dhe botës akademike në procesin e ligjbërjes dhe të kontrollit parlamentar, promovimin e punës kërkimore-shkencore dhe të mendimit analitik në funksion të demokracisë parlamentare, rritjen e perceptimit dhe të kapaciteteve të studentëve mbi parlamentarizmin, përmirësimin e perceptimit publik dhe njohjen më të mirë të funksioneve të Kuvendit të Shqipërisë si dhe mbështetjen e institucioneve arsimore në përmbushjen e funksioneve të tyre në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, ranë dakord:

Neni 1

Kuvendi i Shqipërisë i ofron Universitetit “Ismael Qemali” të Vlorës:

- a) mundësinë për të bashkëpunuar në procesin e hartimit të akteve ligjore prej komisioneve, nënkomisioneve dhe deputetëve të Kuvendit nëpërmjet ekspertizës, konsultave dhe dëgjësive të programuara e të vazhdueshme me njësitë mësimdhënëse e kërkimore-shkencore, pedagogët, ekspertët dhe studentët;
- b) mundësinë për të kontribuar në procesin e kontrollit parlamentar nëpërmjet konsultave dhe bashkëpunimit të komisioneve dhe strukturave të kontrollit parlamentar me pedagogët dhe ekspertët e Universitetit “Ismael Qemali”;
- c) bashkëpunim në organizimin e konferencave, seminareve dhe veprimtarive të tjera të këtij lloji për çështje me interes publik, reforma të rëndësishme, projektligje që kërkojnë konsultim të gjerë etj.;
- ç) ndihmë profesionale dhe bashkëpunim për veprimtaritë e organizuara nga Universiteti “Ismael Qemali”, nëse ato lidhen me aktivitete në fokus të Kuvendit të Shqipërisë;
- d) mundësinë që studentët e Universitetit të kryejnë praktika mësimore pranë Kuvendit të Shqipërisë;
- dh) informacion dhe orientime gjatë procesit të hartimit të tezave të diplomës, tezave të doktoraturës dhe të disertacioneve që lidhen me veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë dhe të organeve të tij;
- e) pjesëmarrjen e stafit të administratës së Kuvendit në projekte kërkimore të organizuara nga Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë;
- ë) ftesa për konferenca dhe veprimtari të tjera parlamentare të organizuara nga Kuvendi i Shqipërisë;
- f) mundësi konsultimi të bazave të të dhënave profesionale të përdorura nga Kuvendi i Shqipërisë;
- g) mundësi për të studiuar literaturën e Bibliotekës dhe të Arkivit të Kuvendit të Shqipërisë;
- gj) bashkëpunim në organizimin e aktiviteteve në Kuvendin e Shqipërisë;
- h) bashkëpunim në realizimin e publikimeve dhe botimeve në fushën e parlamentarizmit;

i) leksione me qëllim edukimin në fushën e parlamentarizmit në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.

Neni 2

Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës i ofron Kuvendit të Shqipërisë:

- a) bashkëpunim në organizimin e konferencave, seminareve dhe veprimtarive të tjera të këtij lloji për çështje me interes publik, reforma të rëndësishme, projektligje që kërkojnë konsultim të gjerë etj.;
- b) pjesëmarrjen e personelit akademik në komisionet e përhershme parlamentare përmes ekspertizës profesionale për çështje të ndryshme me interes publik apo projektligje që janë në proces, në rast se paraqitet kërkesë nga komisioni përkatës në përputhje me fushën e përgjegjësisë;
- c) raporte dhe të dhëna të përpunuara e të përditësuara mbi jetën institucionale dhe parlamentare në vend;
- ç) pjesëmarrjen me analiza, punime të përbashkëta në projekte kërkimore të organizuara në bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë;
- d) bashkëpunim në realizimin e publikimeve dhe botimeve në fushën e parlamentarizmit;
- dh) një sasi të caktuar kopjesh të teksteve, botimeve dhe revistave shkencore, akademike, sipas periodicitetit të publikimit të tyre, botime të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë;
- e) ftesa për *workshop*-e profesionale dhe konferenca me interes për deputetët dhe administratën e Kuvendit të Shqipërisë;
- ë) ndihmë në organizimin e *workshop*-eve profesionale dhe konferencave të Kuvendit të Shqipërisë;
- f) mundësinë për të pasur akses në publikimet më të reja të Universitetit “Ismail Qemali” dhe në punimet shkencore të stafit të tij akademik, në respekt të legjislacionit në fuqi dhe të rregulloreve të brendshme të Universitetit.

Neni 3

Në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, Kuvendi i Shqipërisë dhe Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, janë të gatshëm të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe ta shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat për të cilat shfaqin interes të përbashkët dhe bien dakord.

Neni 4

Kostot që rrjedhin nga përmbushja e detyrimeve të përcaktuara nga kjo marrëveshje u ngarkohen palëve pjesëmarrëse, brenda fondeve buxhetore të përcaktuara. Kjo nuk ndikon në pagesat për ushtrimin e detyrave funksionale administrative, institucionale, pedagogjike dhe botuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë njëvjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse. Nëse njëra palë kërkon zgjidhjen e saj, duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër një muaj përpara datës së propozuar për zgjidhje.

Kuvendi i Shqipërisë

Kryetari

Gramoz RUÇI



Universiteti “Ismail Qemali”

Rektori

Prof. dr. Roland ZISI

